




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Primiari / Bërtarisi Primjen / Prototo Received / Delivered	26 - 11 - 8	201	201
Organ / Mësia Organ / Medinica Org / Unit	Rekord B. Prot. Prot. No.	Shfajca Indeg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	7/55/2018		111



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 302 /2018

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.


Vendimi i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Primgjen / Prodate Received / Delivery	26 - 11 2018	viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot: Pr. Prot: Prot. No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KPM SHCK	7155/2018		112

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

MINISTRINË E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

PËR VITIN

2017

Prishtinë, 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Mbikëqyrjes.....	3
Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....	3
Fushat e mbikëqyrjes.....	4
Raporti për mbikëqyrjen në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.....	5
Organizimi i Brendshëm dhe të Dhënat e të Punësuarve.....	7
Procedurat e Rekrutimit dhe të Avancimit.....	8
Procedurat Disiplinore.....	8
Procedurat e Ankesave.....	9
Procedurat e Vlerësimit.....	9
Procedurat e Pushimeve.....	10
Procedurat e Transferimit.....	10
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....	11
Pezullimi, Ndërprerja dhe Përfundimi i Marrëdhënies së Punës.....	11
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik..	11
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	11
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	11
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	12
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	12
Shënimet/komentet/konkluzionet e përgjithshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	12

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar “Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton “Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË MINISTRINË E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 13.04.2018, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Vendimin me Nr. 1964/2017 i datës 03.10.2017 për themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Vendimin me Nr. 1962/2017 i datës 03.10.2017 për themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimin me Nr. 143/2017 të datës 28.02.2017, Vendimin me Nr. 1370/2017 të datës 04.07.2017, Vendimin me Nr. 1696/2017 të datës 15.08.2017, Vendimin me Nr. 1968/2017 të datës 03.10.2017 dhe Vendimin me Nr. 11.2018 të datës 11.01.2018 për caktimin e Ushtruesit të Detyrës për pozitën "Drejtor i Departamentit të Kulturës";
- Vendimin me Nr. 1675/2017 të datës 08.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Drejtor i IKMM-së";
- Vendimin me Nr. 1990/2017 të datës 03.10.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Drejtor i QRTK-së në Prizren";
- Vendimin me Nr. 2113/2017 të datës 12.10.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa";
- Vendimin me Nr. 2429/2017 i datës 07.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Udhëheqës të Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore";
- Vendimin me Nr. 2482/2017 të datës 13.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore";
- Formulari i planit Individual të Personelit (FPIP) i datës 03.11.2016;
- Vendimin me Nr. 1775/2017 i datës 30.08.2017 për lejimin e pushimit pa pagesë;
- Vendimin me Nr. 1776/2017 i datës 29.08.2017 për lejimin e pushimit pa pagesë;
- Vendimin me Nr. 417/2017 i datës 05.04.2017 për lejimin e pushimit pa pagesë;
- Vendimin me Nr. 1321/2017 të datës 27.06.2017 për lejimin e pushimit të lehonisë dhe Flete lëshimin e datës 24.06.2017;
- Vendimin me Nr. 1639/2017 të datës 01.08.2017 për lejimin e pushimit të lehonisë dhe Flete lëshimin e datës 16.07.2017;
- Vendimin me Nr. 2186/2017 të datës 30.10.2017 për lejimin e pushimit të lehonisë dhe Flete lëshimin e datës 12.10.2017;
- Ankesat e parashtruara në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Lista e vlerësimit dhe E-maili i datës 20.04.2018 nga Berat Hadri lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë;
- Dosjen e nëpunësit civil për pozitën "Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave" dhe Formularin për vlerësimin e punës provuese i datës 22.05.2017;
- Vendimin me Nr. 14/2017 i datës 01.03.2017 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me vdekje;
- Vendimin me Nr. 625/2017 të datës 04.05.2017 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për arritjen e moshës së pensionimit;

- Vendimin me Nr. 388/2017 të datës 30.03.2017 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për arritjen e moshës së pensionimit;
- Planin vjetor të trajnimit;
- Vendimin me Nr. 1967/2017 i datës 02.10.2017 për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës në shërbimin civil dhe Kërkesën për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës në shërbimin civil e datës 29.09.2017;
- Vendimin me Nr. 2642/2017 i datës 26.12.2017 për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës në shërbimin civil;
- Konkursin e datës 04.04.2017 dhe 23.05.2017 dhe 108 marrëveshjet për shërbimet e veçanta;
- Marrëveshjen për transferim e datës 02.06.2017, 10.11.2017;
- Lista e pagave për muajin dhjetor 2017.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit më datë 13.04.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren (QKR) Nr. 01/2014 për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është përfunduar klasifikimi i vendeve të punës. Në këtë institucion janë të punësuar 216 nëpunës civil.

Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar dosjet e personelit dhe ka konstatuar se janë shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil ndërsa si kopje janë marrë tri (3) dosje atë për pozitën "Zyrtar i Lartë për Promovim të Drejtave të Autorit", "Zyrtar për Buxhet dhe Financa" dhe "Zyrtar për Arkiv" dhe në bazë të vlerësimit të gjitha dosjet personale ishin të kompletuara në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të nenit 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë.

Ushtruesit e detyrës: Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2017 ka pasur shtatë (7) pozitë me Ushtrues të Detyrës (Udhëheqës i Divizionit për Promovim Kulturor, Drejtor i Departamentit të Kulturës, Drejtorit i QRTK-së, Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa, Udhëheqës i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturorë, Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore, Drejtor i IKMM-së). Kolegji gjatë shqyrtimit të dosjeve ka konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. 143/2017 të datës 28.02.2017, Vendimit me Nr. 1370/2017 të datës 04.07.2017, Vendimit me Nr. 1696/2017 të datës 14.08.2017, Vendimit me Nr. 1968/2017 të datës 02.10.2017, Vendimit me Nr. 11/2018 të datës 11.01.2018 dhe Vendimit me Nr. 267/2018 të datës 07.03.2018 për caktimin e Ushtruesit të Detyrës për pozitën "Drejtor i Departamentit të Kulturës", Vendimit me Nr. 1990/2017 të datës 03.10.2017 për caktimin e ushtruesit të detyre në pozitën "Drejtor i QRTK-së në Prizren", Vendimit me Nr. 2113/2017 të datës 12.10.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës "Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa", Vendimit me Nr. 2429/2017 të datës 06.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës "Udhëheqës i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore", Vendimit me Nr. 2482/2017 të datës 13.12.2017 për caktimin e ushtrues të detyrës "Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore", Vendimit me Nr. 1675/2017 të datës 08.08.2017 për caktimin e ushtrues të detyrës "Drejtor i IKMM-së", ka konstatuar se pozitat me ushtrues detyre kanë qenë të angazhuara për një periudhë më të gjatë se tre muaj.

Me këto veprime Minsitria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për sa i përket afatit kohorë të caktimit të ushtruesit të detyrës.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. 1370/2017 të datës 04.07.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës "Drejtor i Departamentit të Kulturës", ka konstatuar që nëpunësi civil i caktuar si ushtrues detyrë në këtë pozitë mban pozitën "Zyrtar i Lartë për Promovim të Kulturës".

Me këtë rast caktimi i tij ushtrues detyre është në kundërshtim me nenin 37 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes, që të respektohen të gjitha afatet ligjore lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe të respektohet hierarkia e pozitive për caktimin e ushtruesit të detyrës sipas Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka përgatitur planin e personelit dhe gjatë vitit 2017 ka zhvilluar tri (3) procedura të rekrutimit. Po ashtu në këtë institucion janë lidhur 108 kontrata me marrëveshje për shërbime të veçanta të cilat janë zhvilluar në bazë të konkursit publik dhe nuk ka pasur tejkalim të afateve lidhur me angazhimin e këtyre marrëveshjeve ndërsa 56 nga këto marrëveshje janë lidhur për pozita të shërbimit civil. Tek procedurat e rekrutimit nuk kemi konstatuar të gjetur, mirëpo tek kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2017 ka pasur të angazhuar 108 të punësuar me marrëveshje për shërbime të veçanta të cilat i ka angazhuar në bazë të konkursit të shpallur, ku 56 prej të cilave kanë qenë të angazhuar në pozitën e nëpunësve civil.

Kolegji ka konstatuar që në bazë të nenit 12 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ekzistojnë dy kategori të të punësuarëve: *„pozitat e nëpunësve civilë të karrierës dhe pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës“*.

Në kuptim të kësaj dispozite, pozitat e nëpunësve civil të karrierës apo të jo karrierës, nuk mund të plotësohen me nëpunës me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që të ketë parasysh që për pozitat e shërbimit civil nuk mund të lidhen kontrata me marrëveshjeve për shërbime të veçanta por duhet ndjekur procedurat e parapara me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bazë të Vendimit me Nr. 1962/2017 të datës 02.10.2017, ka të themeluar Komisionin Disiplinor i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar që është në pajtim me nenin 70 paragrafin 3

të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në bazë të vlerësimeve në këtë institucion nuk është iniciuar asnjë procedurë disiplinore.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bazë të Vendimit me Nr. 1964/2017 të datës 02.10.2017 ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili është i themeluar me tre (3) anëtar siç parashihet me dispozitat e nenit 82 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në këtë komision janë parashtruar 24 ankesa, ndërsa nuk ka vendosur për 14 ankesa dhe mbi bazë të kësaj kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve respektivisht të ankesave të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka konstatuar që komisioni nuk ka venduar për 14 ankesa të parashtruar çoftë nga nëpunësit civil po ashtu edhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil, në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave sepse çdo Komision për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është i obliguar të vendos për çdo ankesë konform dispozitave ligjore e cila është parashtruar nga nëpunësit civil po ashtu edhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave që të ndërmarr të gjitha veprimet që për të gjitha ankesat që parashtrohen të vendos në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nuk ka bërë vlerësimin e rezultateve në punës për të gjithë nëpunësit civil pasi që prej 216 nëpunësve 122 nëpunës nuk janë vlerësuar edhe pse Zyra e Personelit e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit më datë 29.11.2017 ka përcjell shkresë për drejtorët e departamenteve dhe udhëheqësi e drejtpërdrejt të nëpunësve civil që vlerësimi i rezultateve të punës duhet të bëhet deri më datë 31.12.2017. Në vitin 2017 për dhjetë (10) nëpunës civil është bërë vlerësimi i periudhës provuese, në këtë rast lidhur me këtë fushë kemi konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1 : Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve, ka konstatuar se prej 216 nëpunësve civil në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit prej tyre 122 nuk janë vlerësuar edhe pse Zyra e Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit më datë më datë 29.11.2017 ka përcjell shkresë për drejtorët e departamenteve dhe udhëheqësi e drejtpërdrejt të nëpunësve civil që vlerësimi i rezultateve të punës duhet të bëhet deri më datë 31.12.2017, në këtë rast mos vlerësimi i rezultateve në punë është shkelje e detyrave të punës pasi që për të gjithë nëpunësit civil

duhet të bëhet vlerësimi i rezultateve në punë dhe me rastin e mos vlerësimit të të gjithë nëpunësve Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e nenit 3 paragrafit 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe udhëheqësit e drejtpërdrejtë të nëpunësve civilë, që të ndërmarrin veprimet ligjore për eliminimin e shkeljeve pasi që për të gjithë nëpunësit civil duhet të bëhet vlerësimi i punës nga udhëheqësit e drejtpërdrejtë të tyre deri më datë 31 dhjetor të vitit për të cilin vlerësohen, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se për dhjetë (10) nëpunës civil është kryer vlerësimi i periudhës provuese dhe në bazë të dosjeve kemi marr një mostër atë për pozitën “Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave” dhe kemi konstatuar se kjo pozitë është rekrutuar në vitin 2016 dhe kandidatit të përzgjedhur Akt Emërimi ju është lëshuar më datë 23.05.2016, ndërsa formulari për vlerësimin e punës provues i është lëshuar më datë 22.05.2017 me çka nënkuptohet se vlerësimi i periudhës provues nuk i është bërë 40 ditë para përfundimit të periudhës provuese ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 9 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që të ndërmerr masat që në të ardhmen për të gjitha vlerësimet e periudhës provuese të bëhen në pajtim me afatet dhe hapat e përcaktuara me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në kopje fizike dhe elektronike, nëntë (9) nëpunëse civile kanë realizuar pushimin e lehonisë, dhjetë (10) nëpunës kanë realizuar pushimin pa pagesë. Në bazë të vlerësimeve për të gjitha pushimet mjekësore, vjetore, pa pagesë janë respektuar dispozitat ligjore.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjatë vitit 2017 ka pasur tri (3) transferime të përhershme të cilat kanë qenë dy të jashtme dhe një të brendshme të cilat janë lidhur me marrëveshja apo edhe me kërkesë për transferim siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka të punësuar 216 nëpunës civil ku 186 janë të punësuar shqiptar, 24 serb, 1 ashkali, 4 turq dhe 1 boshnjak, prej 216 nëpunësve civil 115 janë femra dhe 101 janë meshkuj ndërsa 5 nëpunës civil janë të punësuar nga personat me aftësi të kufizuara.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dy (2) nëpunës civil ka gëzuar të drejtën e pezullimit të dakorduar të vendit të punës në shërbimin civil duke u ndjekur procedurat ligjore. Në bazë të vlerësimit të dosjeve dhjetë (10) nëpunës civil ka marr pushim pa pagesë, asnjë nëpunësi civilë nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës me dorëheqje, nuk ka asnjë nëpunës civil që ju është ndërprerë marrëdhënia e punës me shkarkim. Po në bazë të vlerësimit të dosjeve është konstatuar që dy (2) nëpunësve civil i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, një nëpunësit civil i është ndërprerë marrëdhënia e punës me vdekje.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mban pozitë të shërbimit civil dhe ndonjë post publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë penale ndaj ndonjë nëpunësi civil po ashtu nuk ka asnjë nëpunës që është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit respektivisht zyra e personelit, ka përgatitur planin e trajnimeve në të cilin përfshihen edhe trajnimet po ashtu është përgatitur edhe Formulari 3 individual të trajnimeve, por dhe të cilat trajnime janë marrë

përasysh nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe disa nëpunës civil kanë ndjekur trajnimet, ndërsa nuk ka asnjë nëpunës që ka ndjekur trajnimet me pagesë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, vijimin në punë e mban në formë elektronike. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohet në pajtim me akt emërimet, ndërsa shtesa në pagë gëzojnë IT..

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në vitin 2017 ka pranuar tetë (8) vendime të Këshillit.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në vitin 2017 është monitoruar për vitin 2016 dhe janë dhënë tri (3) rekomandime të cilat janë adresuar.

15. SHËNIMET/KOMENTET PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, ka konstatuar pesë (5) të gjetura dhe ka dhënë pesë (5) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, ka konstatuar se **Theksim i çështjes** tek Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit është se në këtë institucion nuk janë vlerësuar 122 nëpunës civil, dhe kjo është shkelje e dispozitave ligjore në fuqi nga udhëheqësit e drejtpërdrejtë e këtyre nëpunësve civil te cilët kanë mbetur pa vlerësime.

I dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MKRS;
- Arkivit të KPMSHCK.

Hajzer Salihu
Kryetar i Kolegjit



Sabile Avdyli
ZL për Bashkëpunim Profesional

Sabile Avdyli